



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

VENDIM

Nr. 7, datë 16.10.2017

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,
BASHKIA RROGOZHINË

Në mbështetje të neneve 7, 20 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, si dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Bashkisë Rrogozhinë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 51, datë 28.08.2017, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Rrogozhinë, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
 - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
 - c) Rregullorja e Planit;
 - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
 - e) Materiali hartografik:
 - i. Vizioni strategjik;
 - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
 - iii. Ndarja e territorit në njësi;
 - iv. Përdorimi i propozuar i tokës sipas 14 kategorive bazë;
 - v. Infrastruktura e transportit;
 - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.

2. Në Zonat e Rëndësisë Kombëtare brenda territorit administrativ të Bashkisë Rrogozhinë, shpallur si të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit apo me vendime të veçanta, autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara është Këshilli Kombëtar i Territorit.
3. Në Zonat e përcaktuara si të Rëndësisë Kombëtare dhe për Objektet e Rëndësisë Kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore, autoriteti përgjegjës për miratimin e Lejeve të Zhvillimit dhe Ndërtimit, është Këshilli Kombëtar i Territorit.
4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Rrogozhinë duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
5. Ngarkohet Bashkia Rrogozhinë për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentet e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Rrogozhinë, përfshirë, por pa u kufizuar në to, si më poshtë:
- Vendim Nr. 8, datë 18.06.2003 i KRRTRSH-së “Për detyrën e projektimit për hartimin e studimit rajonal dhe mjedisor dhe planit rregullues të zonës turistike Spille, komuna Kryevidh”;
 - Vendim Nr. 4, datë 17.04.2004 i KRRTRSH-së “Për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit të Rrogozhinës”;
 - Vendim Nr. 9, datë 01.06.2012 i KKT-së “Detyra e Projektimit dhe Studimit Urbanistik Pjesor të zonës turistike prej 97 ha në fshatin Greth, Komuna Kryevidh”;
 - Vendim Nr. 8, datë 06.07.2010 i KRRTRSH-së “Detyra e Projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të zonës turistike Vilë Bashtovë, si dhe Studimet Urbanistike Pjesore në zbërthim të këtij plani, Komuna Gosë”;
 - Vendim Nr. 21, datë 04.07.2013 i KKT-së “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Rrogozhinë”.
7. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJKNURI**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDA TOTA**

